

Emri i Lëndës : Hartimi dhe Zhvillimi i Kurrikulës në AMU							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
EDU 403	B	Vjeshtë	2.00	2.00	0.00	3.00	6.00
Lektori		Tidita Abdurrahmani, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Kursi i Kurrikulës u ofron studentëve mundësinë që të njihen me fushën kurrikulare, bazat filozofike, psikologjike, sociale, si edhe teoritë apo qëndrimet e ndryshme mbi kurrikulën. Në të njëjtën kohë studenti do të marrë njohuri teorike po aq sa praktike lidhur me hartimin e kurrikulës së gjuhës angleze për arsimin e mesëm të ulët, zbatimin dhe vlerësimin e saj. Studenti do të njihet me dinamikën e kurrikulës si rezultat i konteksteve të sotme gjithmonë në ndryshim, duke ndikuar fort në jetët e nxënësve, me qëllim që të formojë njerëz të suksesshëm në jetën personale,					
Objektivat		Përgjatë këtij kursi synohet të nxiten dhe të ndihmohen studentët në lidhje me interesat e tyre studimore, duke u thelluar në fushën e Kurrikulës për arsimin e mesëm të ulët . Për këtë arsye mendohet të arrihen këto objektiva; 1) të njihen me paradigmen e kurrikulës së gjuhës angleze për arsimin e mesëm të ulët si dhe qasjet e ndryshme teorike mbi kurrikulën 2) të analizojnë bazat e jashtme kurrikulare, duke u ndalur në kufijtë e jashtëm të kurrikulës 3) të gjykojnë mbi rolin e rëndësishëm që sjell zhvillimi i kurrikulës në sistemin arsimor parauniversitar 4) të sjellin përmes punës kërkimore përvoja të reja në lidhje me hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e kurrikulës së gjuhës angleze në arsimin e mesëm të ulët .					
Konceptet Kryesore		kurrikul, arsim i mesem i ulet, kornize kurrikulare programe, standarde					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Kurrikula, Përkufizime dhe Qasje .Shkallët e Kurrikulës.Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët Ky leksion është një prezantim me kursin.Në këtë leksion bëhen të mundura njohja me programin dhe ecurinë e tijMetodat e kurrikulës; metoda bihevisoriste, menaxheriale, humaniste. Përkufizimi i kurrikulës. Bazat dhe lëmet e kurrikulës Orstein 1-36						
2	Filozofia dhe kurrikulaLeksioni fokusohet kryesisht mbi filozofitë kryesore të hartimit të kurrikulës . Filozofitë kryesore; Idealizmi, Realizmi, Pragmatizmi, Ekzistencializmi. Perenializmi, Esencializmi, Progresivizmi, Orstein 37-63						
3	Teoritë Psikologjike të Kurrikulës dhe Kurrikula e Arsimit të Mesëm të Ulët 6-9. Krahës filozofisë së saj kurrikula ka edhe teoritë psikologjike mbi të cilat hartuesit e kurrikulës bazohen për hartimin e saj. Cështje të shqyrtuara në këtë lëksion janë Bazat psikologjike të kurrikulës. Bihevisorizmi.Psikologjia e zhvillimit. Ndikimi i Piazhesë. Të menduarit dhe të mësuarit; Inteligjenca e shumfishtë Orstein 64-80 Midis teorive psikologjike të hartimit të kurrikulës ky leksion bazohet në teorinë humaniste e cila është edhe një ndër teoritë më të avancuara në fushën e zhvillimit të kurrikulës. Cështje të trajtuara në këtë leksion janë bazat psikologjike të kurrikulës. Njohja dhe kurrikulaFenomenologjia dhe psikologjia humaniste. Qartësimi i vlerave. Fenomenologjia dhe Kurrikula.						
4	Bazat sociale të kurrikulës dhe problematikat me të cilat ndeshet zbatimi i kurrikulës së gjuhës së huaj në arsimin e mesëm të ulët. Krahës bazave psikologjike dhe filozofike kurrikula është edhe një cështje me karakter dhe impakt social. Ky leksion trajton tematika të tilla si Bazat sociale të kurrikulës. Shoqëria, arsimi dhe shkollimiNjë shoqëri dinamike dhe në ndryshim. Shkolla dhe dija si faktor ndryshimi Orstein 111-125						

5	Teoritë e ndryshme të hartimit dhe të zhvillimit të kurrikulës Ky leksion është një hyrje në teoritë e ndryshme të hartimit dhe të zhvillimit të kurrikulës duke filluar nga ato më të qendëruar dhe duke përfunduar me ato më pak të qendëruar. Këndvështrime teorike. Bazat klasike të teorizimit për kurrikulën Ndërtimi i teorisë. Fazat e ndërtimit. Metaforat dhe kompet teorike. Drejtimi në të ardhmen Orstein 125-140
6	Metodat kryesore të hartimit të kurrikulës Ky leksion fokusohet në metodat kryesore të hartimit të kurrikulës përkatësisht ajo e Tyler dhe ajo e Tabas. Në këtë leksion yrajtohen çështje të tilla si : Zhvillimi i kurrikulës. Metoda tekniko-shkencore Modeli i Tilerit dhe Modeli i Tabas. Racionalja bazë. Qëndrimi i mesëm orstein 141-169
7	Grupet e përfshira në hartimin e kurrikulës së gjuhës angleze për arsimin e mesëm të ulët dhe përvojat kurrikulare Ky leksion trajton aktorët dhe grupet e interesit të cilët përfshihen në hartimin e kurrikulës. Në këtë leksion trajtohen çështje të tilla si: Elementët që duhen marrë parasysh në zhvillimin e kurrikulës Përvojat e kurrikulës. Pjesëmarrësit në zhvillimin e kurrikulës. Orstein 170-200
8	Provimi gjysmë final
9	Kurrikula e gjuhës angleze për arsimin e mesëm të ulët përvoja dhe aplikime Leksionet në vijim janë leksione më ilustruese dhe bëjnë një vëzhgim praktik të përvojës shqiptare të zhvillimit dhe hartimit të kurrikulës së gjuhës angleze në arsimin e mesëm të ulët si dhe të zbatimit të saj në nivel shkolle . në këtë leksion trajtohen tematika të tilla si Pjesët përbërëse të hartimit të kurrikulës.Vlerësime të hartimit të kurrikulës. Shembuj praktikë Orstein 201-230
10	Modele përfaqësuese të kurrikulës Modelet e përqendruar tek nxënësi. Shembuj ilustrues nga fusha e kurrikulës Modelet e trajtuara në këtë leksion janë si ato të huaja ashtu edhe ato shqiptare dhe një qasje krahasuese ndërmerret ndaj tyre. Orstein 231-245
11	Dokumentet kurrikulare udhëzuese të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët Në këtë leksion trajtohen me detaj dokumentat politikbërës të kurrikulës sic janë korniza e arsimit parauniversitar dhe standardet.Në këtë leksion trajtohen tematika të tilla si :Qëllimet e arsimit. Burimet e qëllimeve Formulimi i synimeve. Udhëzime për formulimin e objektivave arsimorë Orstein 246-267
12	Natyra e zbatimit të kurrikulës.Zbatimi si proces ndryshimi. Përmirësimi i pranimi të ndryshimit. Shembuj ilustrues nga fusha e kurrikulës Hartimi i kurrikulës është i lidhur ngushtësisht më implementimin apo zbatimin e kurrikulës dhe si i tillë procesi i zbatimit të kurrikulës trantohet me detaje në këtë leksion.Orstein 267-298
13	Temat mësimore për arsimin e mesëm të ulët fusha gjuhë e huaj dhe metodologjitë e aplikuara në këtë nivel Në këtë leksion trajtohen në detaj temat mësimore të fushës gjuhë e huaj që mund të gjenden në nivelin e arsimit të mesëm të ulët dhe metodologjitë e përdorura nga mësuesit për arritjen me sa më shumë efektivitet të rezultateve të të nxënësit. Udhëzues IZHA Gjuhë e Huaj arsim i mesëm i ulët 20-45
14	Bashkërendimi kurrikul vlerësim fusha gjuhë e huaj arsim i mesëm i ulët Në këtë leksion trajtohen tematika të tilla si rezultatet e të nxënësit në nivelin e arsimit të mesëm të ulët,dhe si këto rezultate reflektohen në format e vlerësimit të adoptuara nga mësuesit dhe në metodologjitë dhe qasjet e përdorura prej tyre. Standardet dokument IZHA 34
15	Prezantimi i Detyrave të Kursit Detyrat e kursit janë seanca mikromësimi të simulara të bazuara në një plan ditor të mirë përcaktuar duke marrë për bazë programet mësimore, planin mësimor dhe dokumentat e tjera kurrikulare nga arsimit i mesëm i ulët.
16	Provimi Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.		
Literatura	• Orstein, Allan., Hunkins, Francis. (2003). Kurrikula. Bazat, parimet dhe problemet. ISP, Tiranë. David Pratt. (1980). Curriculum: Design and Development. New York: Macmillan Hamza, Marita., Spahiu, Yllka. (2008). “Kurrikula në bazë shkolle”. Drejtimi i shkollës, udhëzues për drejtuesit e shkollës, IKS, Tiranë. Kurrikula dhe shkolla. ISP, Tiranë Strategjia kombetare e zhvillimit të arsimit parauniversitar. 2015-2020		
Referenca të tjera	• Udhëzues Kurrikula Gjuhë e Huaj Arsim i Mesëm i ulët		
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat			
1	të njihen me paradigmen e kurrikulës si dhe qasjet e ndryshme teorike mbi kurrikulën të analizojnë bazat e jashtme kurrikulare, duke u ndalur në kufijtë e jashtëm të kurrikulës të gjykojnë mbi rolin e rëndësishëm që sjell zhvillimi i kurrikulës në sistemin arsimor parauniversitar niveli arsim i mesëm i ulët të sjellin përmes punës kërkimore përvoja të reja në lidhje me hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e kurrikulës në nivelin e arsimit të mesëm të ulët		
2	të analizojnë bazat e jashtme kurrikulare, duke u ndalur në kufijtë e jashtëm të kurrikulës		
3	të gjykojnë mbi rolin e rëndësishëm që sjell zhvillimi i kurrikulës në sistemin arsimor parauniversitar niveli arsim i mesëm i ulët		
4	të sjellin përmes punës kërkimore përvoja të reja në lidhje me hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e kurrikulës në nivelin e arsimit të mesëm të ulët		
Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme		Sasia	Përqindja
Gjysmë finale		1	20
Kuize		0	0
Projekte		1	10
Projekte semestrale		1	15
Punë laborator		0	0
Pjesëmarrja në mësim		1	10
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			55
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			45
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	2	5	10
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	10	10
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00